

AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI

I

SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“SINAMATI GROUP” SHPK

Sot më 01.12.2022, u themelua një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqërítë tregtare” i ndryshuar, nga personat si vijon:

- (i) **Z. Bajri Sinamati**, shtetas shqiptar, lindur më 01.05.1963, në Bushat, me banim ne adresën: “Rruja Sabaudin Gabrani, godina nr. 7, Njesia Bashkiake nr. 6, Tirane”, e-mail: bajri1963@gmail.com, mbajtës i letërnjoftimit me numër personal: G30501379H; dhe
- (ii) **Z. Behar Sinamati**, shtetas shqiptar, lindur më 07.05.1986, në Bushat, me banim ne adresën: “Rruja Sabaudin Gabrani, godina nr. 7, Njesia Bashkiake nr. 6, Tirane”, e-mail: beharsinamati@gmail.com, mbajtës i letërnjoftimit me numër personal: I605070720

(Z. Bajri Sinamati dhe z. Behar Sinamati në vijim referuar, së bashku, si “**Ortakët**” dhe, veçmas, si “**Ortaku**”).

Shoqëria dhe marrëdhëniet ndërmjet Ortakëve të saj rregullohen nga dispozitat e legjisacionit shqiptar në fuqi dhe dispozitat e këtij statuti (në vijim “**Statuti**”), i cili përbën edhe aktin e themelimit të shoqërisë.

KREU I

**EMRI, FORMA, ZYRA QENDRORE, OBJEKTI I VEPRIMTARISË, KOHËZGJATJA, DEGËT
DHE ZYRAT E PËRFAQËSIMIT, PËRGJEGJËSIA E ORTAKËVE**

NENI 1

Themelimi dhe emri

- 1.1 Më 01.12.2022, Ortakët e sipërpërmendur themeluan një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar të quajtur “**SINAMATI GROUP**” (në vijim “**Shoqëria**”). Shoqëria fiton personalitet juridik pas regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar, të mbajtur nga Qendra Kombëtare e Biznesit.
- 1.2 Ndryshimi i emrit të Shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve.

NENI 2

Forma ligjore

- 2.1 "SINAMATI GROUP" SHPK, ka formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar.
- 2.2 Gjatë ekzistencës së saj, emri i Shoqërisë do të pasohet nga akronimi "SHPK" që tregon formën ligjore të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.

NENI 3

Selia

- 3.1 Shoqëria do të ketë selinë e saj në adresën: "Ruga Sabaudin Gabrani, godina nr. 7, Njësia Bashkiake nr. 6, Tiranë".
- 3.2 Ndryshimi i selisë së shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve.

NENI 4

Objekti i Veprimtarisë

- 4.1 Ndërtime civile, industriale, infrastrukturore, të të gjitha llojeve të lejuara nga legjislacioni në fuqi, përfshirë, por pa u kufizuar, ndërtime dhe rikonstruksione godinash banimi, kapanonesh, ambientesh tregtimi me shumicë dhe/ose pakicë, stabilimentesh dhe fabrikash prodhimi dhe/ose përpunimi të produkteve të ndryshme, rrugësh, kanalësh, digash, etj. Investime në fushën e pasurive të paluajtshme të të gjitha llojeve. Import, eksport dhe tregtim produktesh dhe/ose materialesh ndërtimit të të gjitha llojeve.
- 4.2 Prodhim dhe përpunim tapicerish dhe mobillesh të të gjitha llojeve. Prodhim dhe përpunim druri, duralumini, për kompletimin e brendshëm dhe/ose të jashtëm të banesave, objekteve, godinave, etj. Tregtimin me shumicë dhe pakicë, si dhe import dhe eksport, i mallrave industriale, lëndëve të para për prodhime druri dhe duralumini, etj. Lyerje, bojatisje, izolim, baneshash, objektesh, godinash të ndryshme. Prodhim dhe tregtim, si dhe import dhe/ose eksport, konfeksionesh. Punime gjelbërimi, kopshtarie, etj.
- 4.3 Përveç sa parashikohet në pikat 4.1 dhe 4.2 të këtij neni 4, Shoqëria mund të kryejë të gjitha operacionet tregtare, industriale, financiare, me pasuri të luajtshme dhe/ose të paluajtshme, siç mund të konsiderohen të nevojshme dhe/ose të dobishme përmbrashjen e objektit të veprimtarisë së Shoqërisë, duke saktësuar se aktiviteti financiar mund të kryhet vetëm me qëllim realizimin e objektit të shoqërisë. Ajo gjithashtu mund të blejë kuota dhe/ose aksione në shoqëri të tjera.
- 4.4 Me qëllim realizimin e objektit të veprimtarisë së saj, Shoqëria mund të administrojë, blejë, shesë, të japë me qira si dhe të ketë interesa e pjesëmarrje në shoqëri, të themeluara apo në proces themelimi, që kanë objekt të ngjashëm me objektin e aktivitetit të Shoqërisë, ose që i shërbën realizimit të këtij objekti. Në përgjithësi, Shoqëria mund të kryejë çdo veprimtari të nevojshme e të dobishme, të lejuar nga ligji për realizimin e objektit të aktivitetit të saj.
- 4.5 Shoqëria mund të ofrojë shërbime të tjera ose të kryeje veprimtari të tjera siç vendoset përmes vendimeve të Asamblesë së Përgjithshme në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Paul Luka

2

Blerim Demiri

4.6 Shoqëria mund të ndryshojë objektin e veprimtarisë së saj në çdo kohë, në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar dhe dispozitat e këtij Statuti.

NENI 5

Kohëzgjatja

Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj për një periudhë të pacaktuar.

NENI 6

Degët dhe zyrat e përfaqësimit

Shoqëria mund të hapë degë të saj, shoqëri te lidhura, ose zyra përfaqësimi, dhe të zhvillojë aktivitet në vende të tjera, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

NENI 7

Përgjegjësia e Ortakëve

- 7.1 Ortakët nuk përgjigjen për detyrimet e Shoqërisë dhe mbulojnë personalisht humbjet e Shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara prej tyre.
- 7.2 Ortakët i kryejnë detyrat e tyre me kujdes dhe besnikërinë e duhur në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

KREU III

KAPITALI I REGJISTRUAR DHE KUOTAT, ZMADHIMI DHE ZVOGËLIMI I KAPITALIT, KALIMI I KUOTAVE TË KAPITALIT

NENI 8

Kapitali i regjistruar dhe kuotat

- 8.1 Kapitali i regjistruar i Shoqërisë është 100 000 (*njëqind mijë*) lekë, i cili është nënshkruar nga Ortakët. Kapitali i Shoqërisë është i pashlyer
- 8.2 Ortakët kanë kontribuar në kapitalin e Shoqërisë dhe zotërojnë kuotat e tyre në këtë mënyrë:

- **Z. Bajri Sinamati**, zotëron 1 (*një*) kuotë, me vlerë 50 000 (*pesëdhjetë mijë*) Lekë, e cila përkon me 50% (*pesëdhjetë përqind*) të kapitalit të Shoqërisë; dhe
- **Z. Behar Sinamati**, zotëron 1 (*një*) kuotë, me vlerë 50 000 (*pesëdhjetë mijë*) Lekë, e cila përkon me 50% (*pesëdhjetë përqind*) të kapitalit të Shoqërisë.

8.3 Ortaku Bajri Sinamati do të zotërojë kuotën e tij, të përmendur në pikën 8.2 më sipër, për një periudhë 7 (shtatë) vjeçare nga data e themelimit të Shoqërisë. Në fund të këtij afati, kuota e ortakut Bajri Sinamati i kalon ortakut tjetër Behar Sinamati pa kundërshpërbirim.

8.4 Në çdo rast, pavarësisht sa parashikohet në pikën 8.3 më sipër, Ortaku Bajri Sinamati mund ta transferojë kuotën e tij përpëra afatit të përcaktuar në pikën 8.3 tek çdo palë e tretë, ciladoqoftë, por vetëm nëse Ortaku tjetër, Behar Sinamati, vendos të mos ushtrøjë të drejtën e parablerjes së kuotës në fjalë, në përputhje me nenin 11 të këtij Statuti. E drejta e kalimit të kuotës ndaj palëve të treta mund të ushtrohet vetëm në përputhje me dispozitat e nenit 11 të këtij Statuti.

8.5 Kushtet, e përcaktuara në pikën 8.4 më sipër, për ushtrimin e së drejtës së Ortakut Behar Sinamati për transferimin të kuotës së tij tek palë të treta zbatohen *mutatis mutandis*.

NENI 9

Zmadhimi i kapitalit

- 9.1 Kapitali i regjistruar i Shoqërisë mund të zmadhohet pa kufi, një ose disa herë, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.
- 9.2 Në rast zmadhimi të kapitalit të regjistruar të shoqërisë, të gjithë Ortakët kanë të drejtë të nënshkruajnë dhe shlyejnë pjesët e kapitalit të zmadhuar në proporcion me pjesëmarrjen e tyre në kapital.

NENI 10

Zvogëlimi i kapitalit


- 10.1 Shoqëria mund të zvogëlojë kapitalin e regjistruar me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.
- 10.2 Zvogëlimi i kapitalit i prek Ortakët në proporcion me pjesëmarrjen e tyre në kapital, me përjashtim të rastit kur në bazë të ligjit ose të statutit Asambleja e Përgjithshme mund të vendose ndryshe.

NENI 11

Transferimi i kuotave të kapitalit

- 11.1 Dispozitat e këtij neni të Statutit kanë për qëllim mbrojtjen e interesave të Shoqërisë, unititet të ortakeve dhe ekilibrit të marrëdhënieve midis tyre dhe për këtë arsy vendosen kufizimet e mëposhtme, në rastin e transferimit të kuotave.
- 11.2 Ortakët nuk mund të shesin/dhurojnë ose ndryshe t'i transferojnë kuotat e tyre palëve të treta për një periudhë prej 3 (*tre*) vitesh pasi kanë fituar cilësinë e tyre si Ortakë të Shoqërisë. Ky kufizim nuk është i zbatueshëm në rastet kur Ortakët dëshirojnë të transferojnë kuotat e tyre tek Ortakët e tjera ekzistues të Shoqërisë.

- 11.3 Transferimi i kuotave do të bëhet vetëm nëpërmjet një dokumenti në formë shkresore në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.
- 11.4 Në rast të transferimit të çdo forme të kuotave (përfshirë dhe transferimin pa kundërshpërbirim), tek subjekte të ndryshëm, transferimi do të kushtëzohet nga ushtrimi i së drejtës së parablerjes nga Ortakët aktuale të Shoqërisë, mbi kuotat të cilat synohet të transferohen, në përputhje me rregullat e përcaktuara në dispozitat vijuese.
- 11.5 Ortaku, që ka për qëllim të shesë apo të transferojë pjesëmarrjen e tij në kapital apo një pjesë të saj, duhet të njoftojë me postë të regjistruar dhe/ose e-mail (në vijim, "**Njoftimi i Transferimit**"), Ortaket e tjerë në adresat dhe/ose e-mailet përkatëse të bëra me dije nga vetë Ortakët. Njoftimi i Transferimit duhet të përbajë të dhënët personale të transferuesit të kuotave dhe të përfituesit të tyre, vlerën e kuotave që do të transferohen, kushtet dhe afatet e transferimit, duke përfshirë çmimin (në vijim, "**Çmimi i Paracaktuar**") dhe mënyrat e pagesës.
- 11.6 Njoftimi i Transferimit do të përcaktojë një afat (në vijim "**Afati i Paracaktuar**") i cili nuk do të jetë me pak se 60 (*gjashtëdhjetë*) ditë nga data pasuese e Njoftimit të Transferimit të bërë, brenda së cilës oferta duhet të pranohet ose refuzohet. Njoftimi i Transferimit konsiderohet i parevokueshëm në momentin që është kryer.
- 11.7 Çmimi i Paracaktuar do të jetë një çmim i përcaktuar nga Ortaku ofrues i kuotës dhe do të konsiderohet se reflekton një vlerë të drejtë të kuotës.
- 11.8 Ortakët, të cilëve iu drejtohet njoftimi si më sipër, duhet të ushtrojnë të drejtën e parablerjes mbi pjesëmarrjen së cilës i referohet njoftimi duke i dërguar Ortakut ofrues dhe Administratorit me postë të regjistruar dhe/ose e-mail, brenda afatit të përcaktuar në Njoftim e Transferimit, deklaratën e ushtrimit të së drejtës së parablerjes.
- 11.9 Në rast se Ortakët e tjerë dhe Ortaku ofrues nuk bien dakord me Çmimin e Paracaktuar të kuotave të propozuara përtu transferuar nga ky i fundit, ose vlerën e tregut të kuptave të propozuara përtu transferuar në rastin e transferimit pa kundërshpërbirim, Ortakët e tjerë do të caktojnë një ekspert përtë përcaktuar çmimin sipas vlerës së tregut. Kjo dispozitë është e zbatueshme në rastet kur Çmimi i Përcaktuar është shumë i ndryshëm nga çmimi i tregut.
- 11.10 Duke nënshkruar këtë Statut, Ortakët pajtohen se mendimi i ekspertit do të jetë i detyrueshëm përtor Ortakun ofrues dhe ai do të tërhiqet nga transferimi i kuotave të tij ose do të ndryshojë Çmimin e Përcaktuar në mënyrë që të jetë në përputhje me çmimin e pranueshëm siç vlerësohet nga eksperti dhe të njoftojë Ortakët si më sipër. Në këtë rast, do të zbatohen afatet dhe procedurat e parashikuara në pikat 11.2 deri 11.9 të këtij nenit 11. Çdo transaksion i kryer në shkelje të këtij paragrafi konsiderohet absolutisht i pavlefshëm.
- 11.11 Nëse, në përfundim të Afatit të Paracaktuar, nuk është marrë asnjë njoftim pranimi, ose jo e gjithë kuota e ofruar në Njoftimin e Transferimit është pranuar nga Ortakët e tjerë, Ortaku ofrues ka të drejtë të shesë kuotën e tij tek çdo palë e tretë, ciladoqoftë, në përputhje me Çmimin e Paracaktuar. Ortaku ofrues do të njoftojë paraprakisht me shkrim Ortakët e tjerë dhe Shoqërinë mbi identitetin e palës së tretë (në vijim "**Pala e Tretë Blerëse**") të cilat ai synon ti shesë kuotën.



Amrit 2022



11.12 Do të konsiderohet kusht paraprak mbi të drejtën e çdo Ortaku për të transferuar Kuotat tek Palës së Tretë Blerëse, pranimi i Ortakut të tjerë me shkrim mbi transferimin e kuotë tek drejt Pala e Tretë Blerëse;

11.13 Asnjë Ortak nuk mund të vendosë mbi kuotat asnjë barrë të çfarëdolloj natyre qoftë, përfshirë, por pa u kufizuar, peng, garanci, barrë siguruese, etj., dhe/ose t'i vendosë si objekt i një të drejte për t'i barrësuar pa marrë më parë miratimin me shkrim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve. Asnjë Ortak nuk do të bëhet palë në asnjë marrëveshjeje në lidhje me të drejtën e votës që lidhet me të gjithë apo një pjesë të kuotës së tij.

11.14 Në rast se një Ortak dëshiron të shesë, transferojë apo të disponojë kuotën e tij në përputhje me nën-pikat e këtij neni:

- Ortaku në fjalë do të paguajë të gjitha huatë, kreditë, detyrimet për të cilat ai i detyrohet Shoqërisë (bashke me çdo interes dhe/ose kamatëvonesë të akumuluar);
- Ortakët e tjerë do të sigurohen që Shoqëria do të paguajë të gjithë huatë, kreditë, detyrimet për të cilat Shoqëria i detyrohet Ortakut ofrues (bashkë me çdo interes dhe/ose kamatëvonesë të akumuluar).

11.15 Çdo transferim i kryer në kundërshtim me rregullat dhe kufizimet e këtij neni 11 do të konsiderohet i pavlefshëm dhe Ortaku ofrues do të jetë përgjegjës ndaj Ortakëve të tjerë dhe Shoqërisë për dëmin e shkaktuar.

11.16 Të gjitha njoftimet në funksion të zbatimit të këtij neni do të bëhen me shkrim me postë të regjistruar dhe/ose me e-mail.

KREU IV
ORGANET E SHOQËRISË

NENI 12

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve

Në bazë të legjislacionit të aplikueshëm dhe dispozitave të këtij Statuti, Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve të Shoqërisë është organi më i lartë vendimmarrës i Shoqërisë. Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme të ortakëve, të marra në përputhje me ligjin dhe këtë Statut, janë detyruese për të gjithë ortakët.

NENI 13

Të drejtat dhe detyrimet e Asamblesë së Përgjithshme

Asambleja e Përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për Shoqërinë në lidhje me çështjet e mëposhtme:

- përcaktimin e planit përfundimtar afatgjatë te biznesit dhe vlerësimin e tij vjetor;
- përcaktimin e planit vjetor të biznesit duke përfshirë planin e investimeve;

- c) miratimi i pasqyrave financiare;
- d) përcaktimin e strategjisë vjetore të marketingut, burimeve njerëzore dhe organizimit të shoqërisë;
- e) përcaktimin e emrit të markës dhe dizajnit;
- f) ndryshimet e Statutit;
- g) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- h) emërimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- i) përcaktimin e shpërblimeve për administratorët, likuiduesit dhe ekspertët kontabël të autorizuar;
- j) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët;
- k) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- l) shpérndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- m) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- n) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- o) përfaqësimin e Shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- p) riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë;
- q) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të Asamblesë së Përgjithshme;
- r) çështje të tjera të parashikuara nga ligji nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar dhe/ose ky Statut.

NENI 14

Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve

- 14.1 Asambleja e Përgjithshme mblidhet në rastet e përcaktuara nga ligji dhe nga ky statut, sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e Shoqërisë. Asambleja e Përgjithshme thirret në respektim të parashikimeve të neneve 83 dhe 84 të ligjit nr. 9901, datë 14.01.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar dhe këtij Statuti.
- 14.2 Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve duhet të mblidhet së paku 4 (katër) herë në vit, çdo tre muaj, përveç nëse të gjithë Ortakët paraprakisht bien dakord me shkrim se një mbledhje e caktuar tremujore nuk është e nevojshme dhe si e tillë nuk do të kryhet. Një mbledhje e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve është e detyrueshme që të kryhet të paktën brenda 6 (gjashtë) muajve nga fundi i viti finanziar, për miratimin e pasqyrave financiare të Shoqërisë. Përndryshe, Asambleja e Përgjithshme mund të thirret në çdo kohë që Administratori e konsideron të nevojshme ose kur kërkohet me shkrim nga një ose më shumë ortakë që zoterojnë të paktën 5% (pesë përqind) të kapitalit të Shoqërisë (në vijim referuar si: "Ortakët e Pakicës"). Në rastin e fundit nëse Administratori nuk e thirret asamblenë brenda 15 (pesëmbëdhjete) ditësh nga paraqitja e kërkesës së

Ortakëve të Pakicës, këta të fundit kanë të drejtë ta thérresin vetë Asamblenë e Përgjithshme të ortakëve, duke përcaktuar rendin e ditës, datën, kohën dhe vendin e takimit në përputhje me procedurat e përcaktuara në dispozitat në vijim.

- 14.3 Ortakët do të njoftohen për mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme me anë të një postës së regjistruar dhe/ose e-mailit. Njoftimi duhet të tregojë rendin e ditës, vendin, datën dhe orën e mbledhjes dhe do t'i dërgohet secilit Ortak, të paktën 8 (*tetë*) ditë përparrë datës së mbledhjes. Gjithashtu, njoftimi duhet të përmbarë, edhe mënyrën e pjesëmarrjes në Asamblenë e ortakëve dhe/ose mënyrën e vendimmarjes. Ortakët mund të bien dakord për një çështje, rast pas rasti, përmes një konfirmimi me shkrim, nëpërmjet postës së regjistruar dhe/ose e-mailit, nga të gjithë Ortakët, që afati i tillë të jetë më pak se 8 (*tetë*) ditë, siç është vendosur në shkresën konfirmuese.
- 14.4 Njoftimi i mbledhjes mund të parashikojë edhe një datë të dytë për mbledhjen e Asamblesë në rast se mbledhja e parë nuk zhvillohet sipas njoftimit, në përputhje me përcaktimet e këtij Statuti.
- 14.5 Në rastin kur njoftimi i mbledhjes bëhet nëpërmjet e-mailit, njoftimi konsiderohet i marrë nga ortakët në datën/orën e shënuar në mesazhin e marrjes/dorëzimit të njoftimit të e-mailit.
- 14.6 Ortakët janë të detyruar që të depozitojnë me shkrim pranë administratorit të Shoqërisë adresën në të cilën do t'i dërgohet njoftimi nga shoqëria me anë të postës së regjistruar, si dhe e-mailin (nëse ato janë të ndryshme nga ato të treguara në këtë Statut), ku do t'i dërgohet njoftimi me anë të postës elektronike. Dërgimi i njoftimit në këto adresë do të konsiderohet si njoftim i kryer rregullisht. Është përgjegjësi e Ortakut përkatës të njoftojë çdo ndryshim të këtyre adresave.
- 14.7 Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme mund të mbahet në selinë e Shoqërisë ose në një vend tjeter të propozuar nga administratori dhe të miratuar nga Ortakët. Në këtë rast, Ortakët duhet të dorëzojnë me shkrim miratimin e tyre. Ortakët që përfaqësojnë 75% (*shtatëdhjetë e pesë përqind*) të kapitalit të Shoqërisë duhet të bien dakord nëse dëshirojnë të zhvillojnë mbledhjen në një vend tjeter jashtë selisë së Shoqërisë. Në rast se Ortakët nuk bien dakord për zhvillimin e mbledhjes në një vend tjeter, atëherë mbledhja do të mbahet në selinë e Shoqërisë.
- 14.8 Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve dhe vendimet e saj janë të vlefshme, edhe pa thirrje formale, kur marrin pjesë të gjithë ortakët që përfaqësojnë të gjithë kapitalin e Shoqërisë.
- 14.9 Pas mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, Ortakët përcaktojnë Kryetarin e saj, si edhe Sekretarin e mbledhjes i cili është përgjegjës per mbajtjen e procesverbalit.

NENI 15

Pjesëmarrja në vendime

- 15.1 Çdo Ortak ka të drejtë vote në përpjesëtim me kontributin e tij në kapitalin e Shoqërisë.

15.2 Çdo ortak mund të përfaqësohet në Asamblenë e Përgjithshme nga një Ortak ose nga një person i tretë, në bazë të një autorizimi me shkrim. Ky autorizim mund të jepet vetëm për një mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

15.3 Ortaku nuk mund të përfaqësohet në Asamblenë e Përgjithshme nga Administratori.

NENI 16

Kuorumi dhe vendimmarrja

- 16.1 Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme në çdo rast janë të vlefshme nëse të marrin pjesë personalisht ose të përfaqësuar, Ortakët të cilët zoterojnë më shumë se gjysmën e kapitalit të Shoqërisë.
- 16.2 Për vendime të cilat kërkojnë një shumicë të zakonshme, Asambleja e Përgjithshme merr vendime të vlefshme me 51% (*pesëdhjetë e një përqind*) të votave pro të ortakëve pjesëmarrës në mbledhje në përputhje me nenin 16.1 më sipër.
- 16.3 Për vendime të cilat kërkojnë një shumicë të cilësuar, Asambleja e Përgjithshme merr vendime të vlefshme me $\frac{3}{4}$ (*tre të katërtat*) e votave pro të Ortakëve pjesëmarrës në mbledhje në përputhje me nenin 16.1 më sipër. Këto vendime janë:
- ndryshimi i Statutit,
 - ndryshimi i emërtimit të shoqërisë,
 - ndryshimi i selisë,
 - blerja e kuotave/aksioneve në shoqëri të tjera,
 - shitja e kuotave/aksioneve të shoqërive të tjera,
 - krijimin e filialeve të reja dhe zyrave përfaqësuese dhe degëve jashtë territorit të Shqipërisë,
 - zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar,
 - shpërndarjen e fitimeve dhe dividendëve,
 - riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë,
 - anulimin e kuotave,
 - përjashtimin e ortakut,
 - përcaktimin e planit afatgjatë përfundimtar të biznesit dhe miratimin e tij,
 - përcaktimin e planit vjetor të biznesit duke përfshirë planin e investimeve,
 - miratimin e pasqyrave financiare të shoqërisë,
 - përcaktimin e strategjisë vjetore të marketingut, burimeve njerëzore dhe strategjisë organizative të shoqërisë;
 - përcaktimin dhe miratimin e emrit të markës dhe dizajnit të markës;

A handwritten signature in blue ink, appearing to read "Rrustem Rexhi" followed by the date "2022".

- q. vendimet e ortakëve për ushtrimin e një veprimtarie specifike sipas objektit të veprimitarisë të parashikuar në këtë Statut, që nuk ushtrohet nga Shoqëria në kohën e vendimmarjes.
- 16.4 Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në nenin 16.1, Asambleja e Përgjithshme mblidhet përsëri jo më vonë se 8 (tetë) ditë, me të njëjtin rend dite.
- 16.5 Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme dhe detyruese për Shoqërinë, edhe pa u mbledhur, nëpërmjet shkresës qarkulluese, me kusht që vendimi përkatës të jetë nënshkruar nga të gjithë Ortakët

NENI 17

Procesverbali i mbledhjes

- 17.1 Të gjitha vendimet e Asamblesë së Përgjithshme duhet të regjistrohen në procesverbal. Procesverbali përban datën, vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e Kryetarit të Mbledhjes, emrin e Sekretarit, dhe rezultatet e votimit.
- 17.2 Për mbajtjen e procesverbalit, Kryetari i Mbledhjes cakton një Sekretar, i cili mund të mos jetë Ortak. Procesverbali i mbledhjes nënshkruhet nga Kryetari i Mbledhjes dhe Sekretari.
- 17.3 Prosesverbalit i bashkëngjitet lista e pjesëmarrësve dhe njoftimi i mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme.

NENI 18

Pjesëmarrja përmes mjeteve elektronike

- 18.1 Ortakët mund të marrin pjesë në mbledhjen e Asamblesë nëpërmjet mjeteve elektronike si telekonferanca, video-konferanca, apo komunikimit video-shkrues.
- 18.2 Përdorimi i mjeteve elektronike do të kryhet duke marrë të gjitha masat teknike të nevojshme për garantimin e identifikimit të ortakëve, si edhe sigurinë e këtyre mjeteve elektronike. Në veçanti është e nevojshme që:
- Kryetari i Mbledhjes të ketë mundësinë të verifikojë dhe të identifikojë Ortakët të cilët janë të pranishëm, të kontrollojë mbarëvajtjen e mbledhjes, të numërojë dhe të shpallë rezultatin e votimit;
 - Sekretari të ketë mundësinë per t'u njojur me faktet dhe ngjarjet e ndodhura në mbledhjen, objekt të procesverbalit;
 - Të mundësohet pjesëmarrja e të gjithë Ortakëve të pranishëm për të diskutuar mbi rendin e ditës, në shqyrtimin, marrjen dhe shpërndarjen e të gjitha dokumenteve të përdorura gjate mbledhjes si dhe në procesin e votimit mbi rendin e ditës.
- 18.3 Mbledhja e Asamblesë në kushtet e përmendura në nenin 18.1 dhe vijues të këtij Statuti, konsiderohet rregullisht e mbajtur pavarësisht faktit se Ortakët nuk janë të

pranishëm në të njëtin vend dhe kohë të konferencës në ditën dhe kohën në të cilën konferenca mbahet apo do të konsiderohet se u mbajt pranë selisë së Shoqërisë, nëse nuk bihet dakord ndryshe, të gjithë Ortakët që marrin pjesë në mbledhje do të konsiderohet se kanë qenë të pranishëm me kusht që vendimi të nënshkruhet nga Kryetari i Mbledhjes dhe Sekretari të cilët duhet të jenë në të njëtin vend gjatë mbledhjes.

- 18.4 Kryetari i Mbledhjes do të verifikojë identitetin e çdo ortaku pjesëmarrës ose përfaqësuesve të tyre.
- 18.5 Kuorumi i nevojshëm për telekonferencën do të jetë i njëjtë kuorum i parashikuar në Statut për Asamblenë e Përgjithshme.
- 18.6 Në rast se ortakët janë të ftuar të marrin vendime nëpërmjet konsultimit me shkrim, kuromi do të quhet si i formuar bazuar në numrin e Ortakëve që do të dërgojnë votimin dhe vendimet e tyre me shkrim. Administratori ose çdo Ortak që kërkon vendimmarrjen duhet t'i dërgojnë çdo ortaku njoftimin për konsultimin me shkrim, i cili do të përmbajë gjithë informacionet që përfshihen në letrën e njoftimit/thirrjes të përcaktuar në këtë Statut. Procedura e konsultimit me shkrim duhet të kryhet në përputhje me përbajtjen e këtij neni, në rastet kur zbatohet. Çdo Ortak duhet të shprehet me shkrim në lidhje me projekt-vendimet duke votuar mbi dokumentin e projekt vendimeve në formën e dërguar nga administratori, nëpërmjet shënimit "pro" ose "kundër" ose duke u shprehur komentet e tyre në një dokument tjetër. Në rast se ortakët kanë komente, duhet t'u bëjnë referencë të qartë projekt-vendimeve. Secili ortak duhet t'i dërgojë Administratorit ose ortakëve që kanë kërkuar marrjen e vendimit nëpërmjet këshillimit me shkrim, votën e tij/vendimet me shkrim brenda datës së përcaktuar në njoftimin e dërguar për marrjen e vendimin nëpërmjet konsultimit me shkrim.
- 18.7 Vendimet e ortakëve të marra si dhe diskutimet dhe komentet e ortakëve duhet të pasqyrohen në procesverbalin e mbledhjes të hartuar nga Sekretari i mbledhjes. Gjithashtu ky procesverbal duhet të pasqyrojë mënyrën e organizmit të mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme apo të konsultimit me shkrim nëse është kryer në përputhje me ligjin dhe dispozitat e Statutit, të identifikojë ortakët e pranishëm dhe të përfaqësuar ose ortakët që kanë votuar me shkrim, nëse kuorumi i ortakëve që kanë votuar me shkrim është respektuar sipas Statutit dhe Ligjit për Shoqëritë Tregtare, si dhe nëse vendimet konsiderohen të miratuarë sipas rezultatit të votimeve. Prosesverbali do të nënshkruhet nga Kryetari dhe Sekretari. Prosesverbalist i bashkëngjitet gjithashtu lista e ortakëve që kanë votuar (përveç rastit kur procesverbali është nënshkruar nga gjithë ortakët) si dhe njoftimi i thirrjes së asamblesë të cilat mbahen në selinë e Shoqërisë. Nëse vendimet e marra duhet të depozitoohen pranë Regjistrat Tregtar, procesverbali i mbledhjes dhe votat e dhëna (nëpërmjet konsultimit me shkrim nga ortakët) do të shërbejnë si dokumentet që provojnë të dhënat që do të depozitoohen në këtë regjistër.
- 18.8 Në rast se Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve nuk mund të shqyrtojë në të njëjtën ditë të gjitha çështjet që duhen diskutuar, vazhdimi i mbledhjes do të bëhet të nesërmë pa pasur nevojë për njoftim të mëtejshëm.

NENI 19

Administratori


19.1 Administratori është organi ekzekutiv i Shoqërisë.

19.2 Shoqëria administrohet nga një ose disa administratore që emërohen dhe shkarkohen me vendim të Asamblesë së Përgjithshme. Afati i emëritimit është 5 (pesë) vite me të drejtë ripërtëritje.

19.3 Administratori ka të drejtë të kryejë administrimin e zakonshëm të Shoqërisë. Ai ka të drejtë të përfaqësojë Shoqërinë pranë çdo organi shtetëror si dhe në marrëdhënie me tretë; të hartoje dhe të nënshkruajë çdo dokument të nevojshëm lidhur me mbarëvajtjen e aktivitetit të Shoqërisë si dhe ti depozitojë ato pranë çdo organi kompetent shtetëror, apo personave të tretë privatë, në përputhje me legjislatacionin shqiptar në fuqi. Administratori do te jete përgjegjës por pa u kufizuar per sa me poshtë:

- a) Të kujdeset për mbarëvajtjen e aktivitetit të përditshëm të Shoqërisë, duke kryer të gjitha veprimet e nevojshme lidhur me mbikëqyrjen e personelit; punësimin dhe largimin nga puna të personelit; dhënien e udhëzimeve lidhur me mënyrën e menaxhimit të punëve në Shoqëri; mbajtjen e korrespondencës së Shoqërisë; dhënien e autorizimit për blerjen, marrjen me qira etj. të mallrave apo shërbimeve të zakonshme të cilat lidhen në mënyrë direkte apo të tërthortë me aktivitetin e përditshëm të Shoqërisë; autorizimin për kryerjen e transferimeve bankare apo tērheqjen e shumave të nevojshme nga llogaritë e Shoqërisë lidhur me pagat apo shpërblimet e punonjësve të Shoqërisë; të përpilojë dhe të nënshkruajë faturat tatimore që do të lëshohen në emër të Shoqërisë si rezultat i punëve të kryera; të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme dhe të nënshkruajë çdo dokument për kryerjen e pagesave bankare, depozitime, tērheqje, derdhje, si dhe transferime apo lëvizje të çdo lloji në llogaritë bankare të Shoqërisë, në të gjitha numrat e llogarisë të Shoqërisë, pranë çdo banke ku ndodhen këto llogari;
- b) Të përfaqësojë shoqërinë në lidhje me negocimin, hartimin dhe lidhjen e çdo lloj kontrate ose marrëveshje me persona fizikë apo juridikë vendas ose të huaj, me institucione apo ente të ndryshme shtetërore;
- c) Të zbatojë vendimet e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve;
- d) Të zbatojë planin vjetor të biznesit duke përfshirë planin e investimeve;
- e) Të implementoje strategjinë vjetore të marketingut, strategjinë e burimeve njerëzore dhe organizimin e shoqërisë;
- f) Të vendosë mbi planin operacional të Shoqërisë;
- g) Të hartoje buxhetin financiar vjetor për tu miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve;
- h) Ngritjen e sistemit të administrimit të brendshëm;
- i) Çdo kompetencë tjeter të parashikuar nga Statuti i Shoqërisë.

- 19.4 Për administrimin e zakonshëm të Shoqërisë të përcaktuar në nenin 19.3, Asambleja e Përgjithshme me vendim të posaçëm mund të përcaktojë një shumë limit, me të cilën Administratori mund të kryejë veprimet e sipërcituara.
- 19.5 Për administrimin e jashtëzakonshëm të Shoqërisë, e cila do të kalojë kompetencat e përcaktuara në nenin 19.3 dhe shumën limit, siç mund të jetë vendosur nga Asambleja e Përgjithshme sipas nenit 19.4, Administratori do të kryejë veprime vetëm mbi bazën e një vendimi të Asamblesë së Përgjithshme.
- 19.6 Administratori i parë shoqërisë është z. **Behar Sinamati**:

<i>Të dhëna për administratorin Behar Sinamati</i>	<i>Specimeni i nënshkrimit</i>
Lindur më 07.05.1986 Numër personal identifikimi: I605070720	<i>Behar Sinamati</i> 

NENI 20

Ndalimi i konkurrencës

- 20.1 Ortakët dhe administratori i Shoqërisë nuk mund të kenë pozitë drejtuese, të zoterojnë kuota/aksiione ose të janë të punësuar në ndonjë shoqëri tjetër që vepron në sektor ose biznes të njëjtë ose të ngashëm me atë të shoqërisë, për aq kohë sa ata mbajnë pozicione të tilla në Shoqëri. As nuk mund të mbajnë statusin e një sipërmarrësi për të kryer biznes në të njëjtin sektor. As të marrin pjesë indirekt në të njëjtin sektor. Këto kushte janë të vlefshme për aktivitet tregtar në territorin e Shqipërisë për një periudhë të pakufizuar dhe në territorin e Republikës së Kosovës për një periudhë prej 2 (dy) vitesh nga data e nënshkrimit të këtyre akteve nënligjore.
- 20.2 Kur një nga personat e përmendur në paragrafin 20.1 të këtij neni, shkel klauzolën e ndalimit të konkurrencës, Shoqëria mund:
- a) ta largojë atë person nga shoqëria ose ta largojë atë nga pozicioni i tij;
 - b) të kërkojë ndërprerjen e veprimtarisë konkurruese;
 - c) të kërkojë dëmshpërblim.
- 20.3 Në vend që të kërkojë dëmshpërblim, Shoqëria mund ti kërkojë secilin nga personat e përmendur në paragrafin 20.1 të këtij neni:
- a) të pranojë që transaksionet e bëra në llogarinë e tij të transferohen në llogarinë e Shoqërisë;
 - b) të transferojë tek shoqëria çdo përfitim që ai ka marrë nga transaksionet e bëra për llogarinë e një personi të tretë;
 - c) të transferojë tek shoqëri çdo të drejtë dhe kërkesë që rrjedh nga transaksionet e bëra për llogarinë e një personi të tretë.

KREU V

**EKSPERTI KONTABËL, VITI FINANCIAR DHE BILANCI VJETOR,
SHPËRNDARJA E FITIMEVE**

NENI 21

Audituesi ligjor

21.1 Nëse është e nevojshme ose kërkohet nga ligji, kontrolli i pasqyrave financiare dhe i librave të kontabilitetit të Shoqërisë do t'i besohet një audituesi ligjor, të emëruar nga Shoqëria.

NENI 22

Viti finanziar dhe pasqyrat financiare

- 22.1 Viti finanziar fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor. Përjashtimisht, viti i parë i veprimitarës fillon në datën e regjistrimit të Shoqërisë nën Regjistrin Tregtar dhe përfundon më 31 dhjetor të atij viti.
- 22.2 Pasqyrat financiare vjetore, inventari, raporti i ecurisë së veprimitarës dhe raporti i audituesit ligjor (nëse ka të tillë), miratohen nga Asambleja e Përgjithshme.
- 22.3 Dokumentet që kanë të bëjnë me ushtrimin e vtitit finanziar do të miratohen brenda 3 (tre) muajve nga përfundimi i vtitit finanziar.

NENI 23

Shpërndarja e Fitimeve

- 23.1 Ortakët kanë të drejtë të ndajnë pjesën e fitimit të deklaruar në pasqyrat financiare të Shoqërisë. Fitimi u shpërndahet Ortakëve në përputhjen me kuotat e zotëruara.
- 23.2 Shoqëria mund t'u shpërndajë fitime ortakëve vetëm nëse pas pagimit të dividendëve:
 - aktivet e Shoqërisë mbulojnë tërësisht detyrimet e saj;
 - Shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12 (dymbëdhjetë) muajve në vazhdim.


KREU VI

RIORGANIZIMI I SHOQËRISË, PRISHJA DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË

NENI 24

Prishja dhe likuidimi i Shoqërisë

- 24.1 Shoqëria prishet në rastet e parashikuara nga ligji ose me vendim të Asamblesë së Përgjithshme. Në rast prishjeje, Shoqëria do t'i nënshtrohet procedurës së likuidimit.



14



- 24.2 Për procedurën e likuidimit të Shoqërisë do të zbatohet legjislacioni shqiptar në fuqi.
- 24.3 Likuiduesit do të emërohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve. Emërimi i likuiduesit/eve dhe procesi i likuidimit do të kryhen në përputhje me dispozitat e ligjit shqiptar.

KREU VII
DISPOZITA TE FUNDIT

NENI 25

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve dhe ligji i zbatueshëm

- 25.1 Të gjitha mosmarrëveshjet midis Ortakëve duhet të zgjidhen me mirëkuptim. Në rastet kur ato nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim, secili prej Ortakëve ka të drejtë t'i drejtohet për zgjidhje Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
- 25.2 Për sa nuk është parashikuar në këtë Statut do të zbatohen dispozitat e ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar, si dhe legjislacioni shqiptar në fuqi.
- 25.3 Ky statut u përpilua në 3 (tre njësi origjinale me përbajtje dhe vlerë të njëjtë ligjore, në gjuhen shqipe, u miratua në parim dhe nen për nen, si dhe u nënshkrua nga Ortakët duke vendosur emrin, mbiemrin dhe nënshkrimin e përkates.

Nënshkruar nga:

ORTAKËT

Bajri Sinamati

BAJRI SINAMATI



Behar Sinamati

Behar Sinamati

